# Akt Themelimi

I shoqerise tregtare " **WillDea Park** "sh.p.k

Tirane me date 02/12/2024

Mbeshtetur ne ligjin Nr.9901 date 14.04.2008, "Per shoqerite tregtare" dhe ligjit Nr.9723,date 03.05.2007 "per Q.K.R dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare, me vullnetin e tij te lire, te shprehur dhe ne nenshkrimin e ketij akt-themelimi ne ortaket:

**formulimi**

**Neni 1**

Formohet shoqeria tregetare private e quajtur " **WillDea Park** "SH.P.K. .

Akti i themelimit nga ana e ortakut te vetem konsiderohet dhe si vendim i ortakut te vetem per krijimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar.

Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqipetar, ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacioni ku do te kete seline dega.

**Selia e Soqerise**

**Neni 2**

Selia e shoqerise :

Radhimë, Bashkia Orikum, rruga Nacionale Vlorë-Orikum, Kodi postar: 9505, Koordinatat e detit: ZK.8602,Treguesit e hartës: K-34-123-(256-A).

Per qellime te komunikimit elektronik do te jete adresa **willdea.vlora@gmail.com**

Pronco Ochis

Shoqeria mund te ndryshoj seline e saj, te hape zyra perfaqesie,dege,te krijoj filiale si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te asamblese dhe ortakut te vetem.

**Objektimi I Veprimtarise**

**Neni 3**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushat e :

Krijimi, zhvillimi dhe menaxhimi i një parku sportiv ujor në ishull, i cili ofron mundësi për aktivitete rekreative dhe sportive në ujë, siç janë kajak, paddleboarding, ski ujor, velërim, dhe aktivitete të tjera aventuristike dhe sportive që lidhen me ujin.

Organizimi dhe realizimi i ngjarjeve sportive, konkurrencave dhe programeve trajnimi për individë dhe grupe, me fokus në promovimin e sporteve ujore, shëndetit fizik dhe punës në grup përmes aktiviteteve argëtuese dhe edukative.

Dizajnimi dhe ndërtimi i infrastrukturës për sportet ujore, përfshirë plazhe të sigurta, molle, dhe shërbime me qira për pajisje sportive ujore, duke siguruar standarde të larta sigurie dhe qëndrueshmërie mjedisore për vizitorët.

Ofrimi i aktiviteteve edukative dhe rekreative që promovojnë ndërgjegjësimin për ruajtjen e mjedisit detar, praktikat e qëndrueshme në sportet ujore dhe rëndësinë e mbrojtjes së ekosistemeve të bregdetit dhe deteve.

Promovimi i turizmit të sporteve ujore duke ofruar paketa turistike për individë.

Krijimi, drejtimi i zonave dhe aktiviteteve të përshtatshme për familjet dhe fëmijët për të siguruar që sportet ujore të jenë të aksesueshme dhe të këndshme për të rinjtë, me zona të sigurta dhe aktivitete edukative për moshat e reja.

Ndërtimi i partneriteteve me bizneset lokale dhe autoritetet për të mbështetur zhvillimin e turizmit të sporteve ujorë dhe iniciativave mjedisore, duke kontribuar në zhvillimin e ekonomisë lokale dhe ruajtjen e mjedisit detar.

**Kohezgjatja e shoqerise**

**Neni 4**

Kohezgjatja e shoqerise do te jete pa afat

Ajo mund te zgjase afatin ne cdo kohe dhe per cfardo lloj shkaku.

Ajo mund te shperbehet ne cdo kohe dhe per cfardo lloj shkaku.

**Kapitali I Shoqerise**

**Neni 5**

Kapitali fillestar i shoqerise private " **WillDea Park** "sh.p.k do te jete ***14.000 (katermbedhjetemije) leke***

Kapitali eshte 100% nga kuotat e ortakeve, e ndare ne 1 kuote.

Kapitali themeluar fillestar mund te shtohet ose te pakesohet (por jo nen vleren e kapitalit themeltar fillestar).

**Drejtimi I Shoqerise**

**Neni 6**

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj,ortaket e saj.

Pranco Otis

Ai ( Administratori) eshte perfaqsues i shoqerise ne mardhenie me te tretet dhe ka kompetenca te plota ne drejtimin e saj.

Cdo kontrate do te kryhet prej tij dhe ne rast mungese nga nje perfaqsues i pajisur me prokure te posacme.

**Neni 7**

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakeve te shoqerise.

**Neni 8**

Ortaket themelues kane te drejte te emerojne dhe administratore te tjere te vlerave materiale. Kane te drejte te caktoje financiere, likuidator per problemet e shoqerise si dhe te pajtoje persona tjere si ortake.

**Neni 9**

Konfliktet qe mund te lindin do te zgjidhen ne zbatim te legjislacionit Shqipetar ne Gjykaten shqiptare , rrethi ne varesi te vendit me te afert te selise ne momentin e lindjes se konfliktit .

**Neni 10**

Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme, me tekstin rreth saj.

**Neni 11**

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin Shqipetar ne fuqi dhe vecanerisht te Ligjit Nr.9901 date 14.04.20018 " per krijimin e shoqerive tregtare" , si dhe duke zbatohen per biznesin qe kryen kjo shoqeri.

**Neni 12**

Pronco Olis

Akti i themelimit u perpilua ne 2 kopje, per t'ju shperndare organeve kompetente dhe nje kopje do te mbetet ne dokumentacionin baza te shoqerise"

Akti i themelimit nenshkruhet rregullisht

**" WillDea Park "**sh.p.k

Ortaku i vetem

ODISE PRENÇE